



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 127, Datë 31.05.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20 gërma “b” dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, neneve 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 830/2 prot., datë 27.05.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me Nr. 377 Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.07.2017”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 67, datë 11.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/7 prot., datë 13.04.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.04.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar

dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e aplikimit si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “b”, “c”, “d”;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”.

Në lidhje me mungesën e konstatuar në Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (vërtetim për shlyerjen e Tatim - Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). **Vlerësohet t’i lihet shoqërisë kusht në vendim që të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.**
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 377 Seria T17, në veprimtarinë së tregtimit të energjisë elektrike që nga data 27.07.2017, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119 me afat vlefshmërie deri në datën 27.07.2022.
- Në nenin 16, pika 1, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 10.02.2022, gati 5 (pesë muaj) përpara përfundimit të afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores, ndaj si e tillë vlerësohet që më poshtë në dispozitiv të specifikohet data e fillimit të vlefshmërisë së saj duke filluar nga data 28.07.2022.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike bazuar në Aneksin A të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 377 Seria T17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.07.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.07.2022.
2. Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.